

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
DREJTORINË RAJONALE RRUGORE VERIOR SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Drejtorinë Rajonale Rrugore Verior, Shkodër**, me objekt: “Mbi Zbatimin e Ligjshmërisë, Rregullshmërisë të Aktivitetit Ekonomiko-Financiar dhe Vlerësues”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.07.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 162, datë 12.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 742/8, datë 11.12.2014, i ka rekomanduar z. Nikolin Dedvukaj Drejtor i DRRRV Shkoder, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1.Gjetje nga auditimi: Në analizën e veprimeve të kryera në kontabilitet në llogarinë nr. 31 “Materiale në magazinë”, bazuar në të dhënat e bilanceve të viteve 2012 - 2013, për llogarinë materiale në magazinë, inventari kontabël i kësaj llogarie ka të pasqyruar më pak në bilanc 2,043,020 lekë. Inventari fizik (sipas përmbledhësës së inventarëve) është i njëjtë me të dhënat e bilanceve , por inventari kontabël duhej të ishte me datë 31.12.2013 në vlerën **2,043,020 lekë**, pasi rezulton se kjo vlerë është më pak se kontabiliteti dhe llogaria duhet të sistemohet.

1.1.Rekomandim: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar të marrë masa për sitemimin e tepricës së llogarisë nr. ”31”, “Materilale”, për sa rezulton e pakuadruar me artikujt kontabël përkatës në vlerën **2,043,020 lekë**.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të bilancit të vitit 2013, teprica e llogarisë 24 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, ka një tepricë në vlerën **29,774,755 lekë**, që përbëhet nga 20 ndërtesa me vlerë 1,213,600 lekë, 18 makina me vlerë 26,969,541 lekë dhe Inventarë ekonomik me 1,591,614 lekë. Për këto inventarë nuk llogaritet amortizim mbasi janë të trashëguar prej vitesh.

2.1.Rekomandim: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të marrë masa për ngritjen e komisioneve me specialistë përkatës, për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve me vlerë **29,774,755 lekë**, të pasqyruar në llogarinë 204 ”Aktive të qëndrueshme të dëmtuara”, që përbëhet nga 20 ndërtesa me vlerë gjithsej **1,213,600 lekë**, 18 makina me vlerë **26,969,541 lekë** dhe inventarë ekonomik me vlerë **1,591,614 lekë**.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se nuk është bërë përmbledhje e llogarive në centralizator apo në libër të madh, nuk është mbajtur ditari i veprimeve të ndryshme për rregullimin e gabimeve në kontabilizime gjatë vitit dhe regjistrimin e artikujve kontabël për mbylljen e llogarive në fund të periudhave ushtrimore. Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare “neni 3 pika 1 dhe VKM nr.783 datë, 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabile”, pjesa e parë “Rregulla të përgjithshme”, kapitulli i parë “ Mbajtja e kontabilitetit”.

3.1.Rekomandim:Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të marrë masa për azhurnimin e librit përmbledhës të llogarisë (centralizatori apo libri madh) dhe ditarin e veprimeve të ndryshme, për mbylljen e llogarive në fund të vitit ushtrimor.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Në 5 tendera, e konkretisht:

a. Në tenderin e zhvilluar në vitin 2012 me objekt **“Riparim Ura Dardhë në km 27.2”**, në përcaktimin e fondit limit u krahasuan çmimet e manualit sipas, VKM nr.708, datë 12.10.2011, rezultoi se nuk është zbatuar çmimi sipas manualit dhe ka sjellë për rrjedhojë rritjen artificiale të çmimit të kontratës, në kundërshtim me pikën 1/c të KREU V të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

b. Në tenderin e zhvilluar në vitin 2013 me objekt **“Riveshje segmenti rrugorë 2 km, Koplík - Malësi e Madhe”**, fondi limit është përllogaritur nga njësia e prokurimit Në dosjen e tenderit nuk ka dokument “urdhër” për ngritjen e komisionit të vlerësimit të fondit limit dhe specifikimeve teknike (KLLFLST), siç përcaktohet në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu II, pika 2/c dhe në ligjin nr.10296 datë 8.7.2010 për “Menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, neni 15,22. Nga krahasimi i preventivit të hartuar me buletinin përkatës nr.407, datë 27.6.2012, “Për Miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Komisioni i vlerësimit të ofertave, ka skualifikuar padrejtësisht bashkimin e operatorëve ekonomikë “A...& D...” shpk; me vlerë të ofertës 18,385,830 lekë, e për rrjedhojë ka sjellë përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore në shumën 1,024,385 lekë.

c. Në tenderin e zhvilluar në vitin 2014, me objekt **“Mirëmbajtje rutinë e dimërore rruga Peshkopi–Qaf Draj 49 km”**, fondi limit është hartuar nga njësia e prokurimit. Në llogaritjen e fondit limit, për zërin e punës “Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm, me makineri”. Njësia e prokurimit, nuk i është përmbajtur VKM, 568, datë 27.06.2013, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike”, për rrjedhojë ka sjellë rritjen artificialisht të vlerës së kontratës në shumën 621,600 lekë.

d. Në tenderin e zhvilluar në vitin 2014 me objekt **“Mirëmbajtje rutinë dimërore rruga KR/Hadroj Qafë Bene 27 km”**, mbështetur në krahasimin e çmimeve të përdorura në preventivin e fondit limit me manualin, në zërin nr. 3.222/2. “Shtresë binderi me granil gur kave,6 cm, me makineri” sipas buletin të VKM, 568, datë 27.06.2013, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike”, është 908 lekë për m2, ndërsa në preventivin e fondit limit është aplikuar me çmimin 1426 lekë/m2, ose më i lartë se manuali me 518 lekë /m2. Llogaritja e volumit në preventiv në sasinë 2000 m2, ka sjellë rritje artificiale të vlerës së kontratës në shumën 1,036,000 lekë.

e. Në tenderin e zhvilluar në vitin 2014 me objekt **“Mirëmbajtje rutinë dimërore rruga Ura e Drinit ZI- Krumë 30 km”**, mbështetur në llogaritjen e fondit limit, për zërin e punës “Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm, me makineri”, njësia e prokurimit, nuk i është përmbajtur VKM, 568, datë 27.06.2013, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, e për rrjedhojë ka sjellë rritjen artificialisht të vlerës së kontratës në shumën 787,144 lekë.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të marrë masa që për llogaritjen e vlerës së kontratës (fondit limit) për kontratat e shërbimit, por që përmbajnë volume pune me “matje” dhe që janë elementë të kontratës “Për punë”, detyrimisht ti përmbahen manualit teknik të çmimeve të ndërtimit.

Menjëherë

5.Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të marrë masa, të vlerësojë të gjitha pagesat për ditë pune, të shumës 3% të vlerës së kontratës, sipas argumentimit të pasqyruar në procesverbale për punime të shpejta, punime të tjera të ndryshme dhe shtesa të pa parashikuara dhe të pa shoqëruara me dokumentacionin përkatës si vendndodhja e vendit të punimeve, fotografitë përkatëse, listëpagesa e punonjësve si dhe dokumentimi i momentit të punimeve me makineritë përkatëse, duke pasqyruar të gjithë elementët e nevojshëm, që argumentojnë përdorimin e fondit në vlerën 3% të vlerës së kontratës.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 08.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, pjesa e VI, kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 20.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kapitulli IV (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **11,748,983 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore dhe shkallët e gjykimit sa më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2012 me objekt “**Mirëmbajtje rutinë e dimërore Segmenti Rrugor Kolsh-Qaf Shllak, 41 km (emergjencë)**”, operatori ekonomik “**O...**”, i shpallur fitues, në situacionin përfundimtar për periudhën 6.12.2012 deri 6.5.2012, në listën nr.4 “Mirëmbajtje dimërore” ka situacionuar vlerën për 1 vit dimëror në shumën 5,085,000 lekë, ndërsa duhej të situacionohej vlera për periudhën faktike dimërore 6.12.2012 deri 15.3.2013, gjithsej 100 ditë kalendarike, nga 120 ditë të situacionuara, pra është situacionuar më tepër nga fakti 16,7 % e ditëve kalendarike dhe operatori ekonomik “**O...**” ka përfituar padrejtësisht vlerën **1,019,034 lekë**, që përbën dëm ekonomik. Gjithashtu duhet korriguar edhe vlera në “Lista nr.8” - Ditë pune (3% e çmimit të kontratës). Nga rillogaritja ky zë duhej paraqitur në situacionin përfundimtar për më pak në vlerën **30,571 lekë** dhe përbën dëm ekonomik.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër-ARRSH, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës **1,049,605 lekë**, nga shoqëria “**O...**”, pasi ka përfituar padrejtësisht vlerën e punës së pa kryer për “Mirëmbajtje dimërore” dhe ka situacionuar shërbim mirëmbajtje dimërore pas periudhës dimërore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2012 me objekt “**Mirëmbajtje rutinë e dimërore Segmenti Rrugor Qaf Bualli- Ura e Topojanit, 30 km (emergjencë)**”, operatori ekonomik “**V...I.S.**”, në situacionin përfundimtar për periudhën 10.12.2012 deri 10.5.2012, në listën nr.4 “Mirëmbajtje dimërore”, ka situacionuar vlerën për 1 vit dimëror në shumën 4,228,301 lekë pa t.v.sh., ndërsa duhej të situacionohej vlera për periudhën faktike dimërore 10.12.2012 deri 15.3.2013, gjithsej 94 ditë kalendarike, nga 120 ditë të situacionuara, pra është situacionuar më tepër nga fakti 21.6 % e ditëve kalendarike, ose 26 ditë kalendarike dhe operatori ekonomik “**V... I.S & A...**”, ka përfituar padrejtësisht vlerën **1,095,975 lekë**, që përbën dëm ekonomik. Gjithashtu duhet korektur edhe vlera në “Lista nr.8” - Ditë pune (3% e çmimit të kontratës). Nga rillogaritja ky zë duhej paraqitur në situacionin përfundimtar për më pak në vlerën **32,879 lekë** dhe përbën dëm ekonomik.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës **1,128,854 lekë**, nga shoqëria “**V...I.S.**”, pasi ka përfituar padrejtësisht vlerën e punës së pa kryer për “Mirëmbajtje dimërore” dhe ka situacionuar shërbim mirëmbajtje dimërore pas periudhës dimërore.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2012 me objekt “**Mirëmbajtje rutinë e dimërore Autostrada Tunel –Morinë 42 km (emergjencë)**”, operatori ekonomik “**M...**”, në situacionin përfundimtar për periudhën deri 6.5.2013, në listën nr.4 “Mirëmbajtje dimërore” ka situacionuar vlerën për 1 vit dimëror në shumën 10,936,500 lekë pa tvsh, ndërsa duhej të situacionohej vlera për periudhën faktike dimërore 6.12.2012 deri 15.3.2013, gjithsej 100 ditë kalendarike, nga 120 ditë të preventivuara, pra është situacionuar më tepër nga fakti 16,5 % e ditëve kalendarike dhe operatori ekonomik “**M...**” ka përfituar padrejtësisht vlerën **2,165,427 lekë**, që përbën dëm ekonomik. Gjithashtu duhet korektur edhe vlera në “Lista nr.8” - Ditë pune (3% e çmimit të kontratës). Nga rillogaritja ky zë duhej paraqitur në situacionin përfundimtar për më pak në vlerën **64,963 lekë** dhe përbën dëm ekonomik.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës **2,230,390 lekë**, nga shoqëria “*M...*”, pasi ka përfituar padrejtësisht vlerën e punës së pa kryer për “Mirëmbajtje dimërore” dhe ka situacionuar shërbim mirëmbajtje dimërore pas periudhës dimërore.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2012 me objekt “**Mirëmbajtje rutinë e dimërore rruga B.Curri-Kam 43 km (emergjencë)**”, nga operatori ekonomik “*D...I*”, në situacionin përfundimtar për periudhën nga 10.12.2012 deri 10.5.5.2013, në listën nr.4 “Mirëmbajtje dimërore” ka situacionuar vlerën për 1 vit dimëror në shumën 5,320,000 lekë pa tvsh, ndërsa duhej të situacionohej vlera për periudhën faktike dimërore 10.12.2012 deri 15.3.2013, gjithëj 99 ditë kalendarike, nga 120 ditë të situacionuara, pra është situacionuar më tepër nga fakti 21% e ditëve kalendarike dhe operatori ekonomik “*D...I*” ka përfituar padrejtësisht vlerën **1,340,640 lekë**, që përbën dëm ekonomik. Gjithashtu duhet korektuar edhe vlera në “Lista nr.8” - Ditë pune (3% e çmimit të kontratës). Nga rillogaritja ky zë duhej paraqitur në situacionin përfundimtar për më pak në vlerën **40,219 lekë** dhe përbën dëm ekonomik.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës **1,380,859 lekë**, nga shoqëria “*D...I*”, pasi ka përfituar padrejtësisht vlerën e punës së pa kryer për “Mirëmbajtje dimërore” dhe ka situacionuar shërbim mirëmbajtje dimërore pas periudhës dimërore.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2012 me objekt “**Mirëmbajtje rutinë e dimërore Kr. Rruga e Kombit-Skuraj-Q.Buall 74 km (emergjencë)**”, operatori ekonomik “*V... I.S.*”, në situacionin përfundimtar për periudhën nga 7.12.2012 deri 7.5.2013, në listën nr.4 “Mirëmbajtje dimërore” ka situacionuar vlerën për 1 vit dimëror në shumën 10,288,000 lekë pa t.vs.h, ndërsa duhej të situacionohej vlera për periudhën faktike dimërore 7.12.2012 deri 15.3.2013, gjithëj 98 ditë kalendarike, nga 120 ditë të situacionuara, pra është situacionuar më tepër nga fakti 19 % e ditëve kalendarike dhe operatori ekonomik “*V...I.S.*” ka përfituar padrejtësisht vlerën **2,345,664 lekë**, që përbën dëm ekonomik. Gjithashtu duhet korektuar edhe vlera në “Lista nr.8” - Ditë pune (3% e çmimit të kontratës). Nga rillogaritja ky zë duhej paraqitur në situacionin përfundimtar për më pak në vlerën **70,369 lekë** dhe përbën dëm ekonomik.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës **2,416,033 lekë**, nga shoqëria “*V...I.S.*”, pasi ka përfituar padrejtësisht vlerën e punës së pa kryer për “Mirëmbajtje dimërore” dhe ka situacionuar shërbim mirëmbajtje dimërore pas periudhës dimërore.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2012 me objekt “**Mirëmbajtje rutinë e dimërore Rruga e Cerecit-Streblevë 39 km (emergjencë)**”, operatori ekonomik “*Sh...*”, në situacionin përfundimtar për periudhën nga 6.2.2012 deri 6.5.2013, në listën nr.4 “Mirëmbajtje dimërore” ka situacionuar vlerën për 1 vit dimëror në shumën 4,836,000 lekë pa tvsh, ndërsa duhej të situacionohej vlera për periudhën faktike dimërore 6.12.2012 deri 15.3.2013, gjithëj 99 ditë kalendarike, nga 120 ditë të preventivuara, pra është situacionuar më tepër nga fakti 18 % e ditëve kalendarike dhe operatori ekonomik “*Sh...*” ka përfituar padrejtësisht vlerën **1,015,560 lekë**, që përbën dëm ekonomik. Gjithashtu duhet korektuar edhe vlera në “Lista nr.8” - Ditë pune (3% e çmimit të kontratës). Nga rillogaritja ky zë duhej paraqitur në situacionin përfundimtar për më pak në vlerën **31,337 lekë** dhe përbën dëm ekonomik.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës **1,046897 lekë**, nga shoqëria “*Sh...*”, pasi ka përfituar padrejtësisht vlerën e punës së pa kryer për “Mirëmbajtje dimërore” dhe ka situacionuar shërbim mirëmbajtje dimërore pas periudhës dimërore.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2012 me objekt “**Mirëmbajtje rutinë e dimërore Rruga Qaf Qelë –Pukë 28.1 km (emergjencë)**”, operatori ekonomik “*B...2006*”, në situacionin përfundimtar për periudhën nga 6.12.2012 deri 6.5.2013, në listën nr.4 “Mirëmbajtje dimërore” ka situacionuar vlerën për 1 vit dimëror në shumën 3,500,000 lekë pa tvsh ndërsa duhej të situacionohej vlera për periudhën faktike dimërore 6.12.2012 deri 15.3.2013, gjithëj 99 ditë kalendarike, nga 120 ditë të situacionuara, pra është situacionuar më tepër nga fakti 17.5 % e ditëve kalendarike dhe operatori ekonomik “*B...2006*” ka përfituar padrejtësisht vlerën **735,000 lekë**, që përbën dëm ekonomik. Gjithashtu duhet korektuar edhe vlera në “Lista nr.8” - Ditë pune (3% e çmimit të kontratës). Nga rillogaritja ky zë duhej paraqitur në situacionin përfundimtar për më pak në vlerën **22,050 lekë** dhe përbën dëm ekonomik.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës **757,050 lekë**, nga shoqëria “*B...2006*”, pasi ka përfituar padrejtësisht vlerën e punës së pa kryer për “Mirëmbajtje dimërore” dhe ka situacionuar shërbim mirëmbajtje dimërore pas periudhës dimërore.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2012 me objekt “**Mirëmbajtje rutinë e dimërore Rruga Plepa –Kam 23 km (emergjencë)**”, operatori ekonomik “*E...&A...*”, në situacionin përfundimtar për periudhën nga 13.12.2012 deri 13.5.2013, në listën nr.4 “Mirëmbajtje dimërore” ka situacionuar vlerën për 1 vit dimëror në shumën 2,852,000 lekë pa tvsh, ndërsa duhej të situacionohej vlera për periudhën faktike dimërore 13.12.2012 deri 13.3.2013, gjithëj 92 ditë kalendarike, nga 120 ditë të situacionuar, pra është situacionuar më tepër nga fakti 23.3 % e ditëve kalendarike dhe operatori ekonomik “*E...&A...*”, ka përfituar padrejtësisht vlerën **797,419 lekë**, që përbën dëm ekonomik. Gjithashtu duhet korektuar edhe vlera në “Lista nr.8” - Ditë pune (3% e çmimit të kontratës). Nga rillogaritja ky zë duhej paraqitur në situacionin përfundimtar për më pak në vlerën **23,922 lekë** dhe përbën dëm ekonomik.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës **821,341 lekë**, nga shoqëria “*E...&A...*”, pasi ka përfituar padrejtësisht vlerën e punës së pa kryer për “Mirëmbajtje dimërore” dhe ka situacionuar shërbim mirëmbajtje dimërore pas periudhës dimërore.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar në vitin 2012 me objekt “**Mirëmbajtje rutinë e dimërore Rruga Kukës –Draj –Rec 26 km (emergjencë)**”, operatori ekonomik “*A...*”, në situacionin përfundimtar për periudhën nga 6.12.2012 deri 6.5.2013, në listën nr.4 “Mirëmbajtje dimërore” ka situacionuar vlerën për 1 vit dimëror në shumën 3,221,500 lekë pa tvsh ndërsa duhej të situacionohej vlera për periudhën faktike dimërore 6.12.2012 deri 15.3.2013, gjithëj 100 ditë kalendarike, nga 120 ditë të preventivuara, pra është situacionuar më tepër nga fakti 16.7 % e ditëve kalendarike dhe operatori ekonomik “*A...*”, ka përfituar padrejtësisht vlerën **645,588 lekë**, që përbën dëm ekonomik. Gjithashtu duhet korektuar edhe vlera në “Lista nr.8” - Ditë pune (3% e çmimit të kontratës). Nga rillogaritja ky duhej të ishte për më pak në vlerën **19,367 lekë** dhe përbën dëm ekonomik.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme

administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës **664,955 lekë**, nga shoqëria “A...”, pasi ka përfituar padrejtësisht vlerën e punës së pa kryer për “Mirëmbajtje dimërore” dhe ka situacionuar shërbim mirëmbajtje dimërore pas periudhës dimërore.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: U konstatuan pagesa të kryera në favor të “A...”, për biseda ndërkombtare të pa programuara dhe jo për nevoja pune, për 6 punonjës në shumën gjithsej **41,442 lekë**.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës **41,442 lekë**, pasi janë kryer pagesa në favor të “A...”, për biseda ndërkombtare të pa programuara dhe jo nevoja pune nga:

N.K. në shumën **12,057 lekë**.

Sh.S. në shumën **12,057 lekë**

Z.Gj. në shumën **4,332 lekë**.

V.N. në shumën **4,332 lekë**

H.S. në shumën **4,332 lekë**

E.Sh. në shumën **4,332 lekë**,

Menjëherë

11.Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 71, datë 3.5.2012, në kundërshtim me VKM nr.997, datë 10.12.2010, ”Për trajtimin financiarë të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” pika e III-të 1, janë paguar më tepër në vlerën **146,500 lekë**, për 4 persona, për shërbim në qytetin e Pukës, për 9 dieta të plota, në distanca më të vogla se 100 km. Nga rillogaritja rezultoi se janë paguar më tepër shpenzime udhëtim e dieta në qytetin e Pukës për 9 ditë dieta të plota, për ish drejtorin N. K. në shumën 40,500 lekë, për S.B. në shumën 40,500 lekë, për V.N. në shumën 40,500 lekë, për Z.Gj. në shumën 25,000 lekë.

Me urdhër shpenzimi nr. 91, datë 11.6.2012, në kundërshtim me VKM nr.997, datë 10.12.2010, ”Për trajtimin financiarë të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” pika e III-të 1, janë paguar më tepër në vlerën **65, 000 lekë**, për 4 persona.

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e vlerës **211,500 lekë**, pasi janë kryer pagesa më tepër për dieta të plota për shpenzime udhëtim e dieta, në distanca nën 100 km, për 4 persona, nga:

N.K. në shumën **55,500 lekë**.

Z.Gj. në shumën **40,000 lekë**.

V.N. në shumën **55,500 lekë**.

S.B. në shumën **60,500 lekë**.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

I. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve për periudhën 01.01.2012 deri më 30.07.2014, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet përkatëse, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit. Mbështetur në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” të ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, do të

rekomandonim Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për punonjësit:

1.Z. N.K., në cilësinë e ish Titullarit të Autoritetit Kontraktor, për arsye se në llogaritjen e fondit limit “Mirëmbajtja rutinë” do të kryhet për një periudhë 5 mujore, ndërsa “Mirëmbajtja dimërore” është llogaritur për 1 vit dimëror. Në preventiv nuk cilësohet data në cilën është bërë kjo llogaritje. Në rastin konkret duhej cilësuar data e fillimit dhe mbarimit të periudhës dimërore, pasi VKM nr.804, mban datën 21.11.2012 dhe për ndryshimin në rregjistrin e prokurimit autoriteti kontraktor ka marrë njoftim zyrtar me datë 7.12.2012, ndërkohë që ka filluar periudha dimërore dhe ngarkon me përgjegjësi ish Titullarin.

2.Z.F.Sh., me detyrë ish specialist, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

3.Z.D.Gj., me detyrë ish specialist, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

4.Z. Z.Gj., me detyrë, Përgjegjës i Sektorit të Mirëmbajtjes, Financës dhe Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

5.Z.P.P., me detyrë ish specialist, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

6.Znj.A.Z., me detyrë specialist. në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.

7.Z. V.N., me detyrë specialist. në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.

8.Z.E.S., me detyrë specialist. në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.

Për arsye se:

-Në vitin 2012, në 11 tendera u konstatuan shkelje e mangësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Në vitin 2013, në 17 tendera u konstatuan shkelje e mangësi në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

-Dosjet e tenderave të zhvilluar në vitin 2012, nuk ishin të inventarizuar dhe ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit.

-Në dosje mungojnë dokumentat e tenderit, në mospërputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu V, ‘Zhvillimi i procedurave’, neni 41, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Në procedurën e kufizuar dhe në procedurën me negociim dokumentet e tenderit janë të përfshira në ftesën për ofertë ose në ftesën për negociim.

-Në dosjen e tenderit nuk ka dokument apo procesverbal, që të jetë marrë vendimi për shoqëritë që do të ftohen, në mospërputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreu V, ‘Zhvillimi i procedurave’, neni 40, “Ftesa për ofertë”, pika 1.

Nga auditimi rezulton se procesverbali i negociimit dhe vlerësimit i mbajtur nga komisioni i vlerësimit të ofertave, nuk është nënshkruar nga anëtarët e njësisë së prokurimit, në mospërputhje me VKM nr.1, datë 10.1.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar, Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 4, “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, germa “a”, paragrafi i dytë, “Anëtarët e njësisë së prokurimit, që kanë marrë pjesë në hartimin e dokumenteve të tenderit, janë të pranishëm gjatë fazës së hapjes dhe të vlerësimit, por nuk kanë të drejtë të votojnë ose të ndikojnë në procesin e shqyrtimit. Ata mund të japim mendime vetëm kur u kërkohet, si dhe kryejnë funksione të karakterit ndihmës, si mbajtja e procesverbalit, sistemimi dhe ruajtja e dokumenteve, etj”.

- Oferta ekonomike dhe preventivi i paraqitur në tender nga operatorët ekonomikë, nuk është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në mospërputhje me VKM nr.1, datë 10.1.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit”, i ndryshuar, Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 4, “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, germa “b”.

Shënim:

1-Rekomandimi për gjobë konsiderohet i ezauruar pasi APP, me vendimin nr. 48, datë 5.6.2014, në mbështetje të neneve 13, pika2/i dhe 72 të LPP, për shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik, ka vendosur:

-Të dënojë z. N.K., titullar i AK, me gjobë në masën 1,000,000 lekë.

-Të dënojë znj. A. Z.a, z. V.N.,z. E.S., anëtar të njësisë së prokurimit, me gjobë në masën 500,000 lekë.

-T'i propozojë titullarit të AK marrjen e masave disiplinore ndaj z. Sh.S., z. P.P., z. D. Gj.Z. dhe Z.GJ., anëtarë të KVO.

Propozimi për dhënie “masa disiplinore” nga Agjencia e Prokurimit Publik, konsiderohet i ezauruar.

Për drejtuesit e mësipërm për të cilët janë dhënë masa administrative dhe disiplinore të njoftohet Departamenti i Administratës Publike për masat disiplinore me qëllim kryerjen e regjistrimeve të nevojshme në Regjistrin Qendror të Personelit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Milo Pano, Pal Daci, Mirosh Bogdo dhe Mirland Cela më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT